



REPUBLIKA E SHqipëRIE
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

QERSHOR 2022

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Qershor 2022

© Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2022
Drejtoria e Analizave Makroekonomike dhe Statistikave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë

www.financa.gov.al

E-mail: Dajana.Metolli@financa.gov.al

Përmbajtja

VEÇORITË KRYESORE _____ **2**

ZHVILLIMET EKONOMIKE _____ **3**

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit _____ 3
2. Kursi mesatar i Këmbimit _____ 4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave _____ 5
4. Bilanci i Pagesave _____ 6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar _____ 7
6. Kredia për Ekonominë _____ 8
7. Oferta e Parasë _____ 9
8. Depozitat sipas burimeve _____ 10

SEKTORI FISKAL _____ **11**

1. Buxheti i Konsoliduar _____ 11
2. Të Ardhurat Sipas Burimeve _____ 12
3. Financimi i Bilancit Fiskal _____ 13

ANEKSI STATISTIKOR _____ **13**

Veçoritë Kryesore


- Indeksi i çmimeve të konsumit në muajin Qershor 2022, arriti në 109;
- Norma vjetore e inflacionit për muajin Qershor 2022 ishte 7.4 përqind;
- Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin Qershor 2022 ishte 113.25 lekë për dollarë dhe 119.8 lekë për euro;
- Normat e interesit të depozitave në lekë gjatë muajit Qershor 2022 shënuan kuotën 0.65 përqind për ato 12-mujore; 0.42 përqind për depozitat 6-mujore; 0.22 përqind për depozitat 3-mujore dhe 0.92 përqind për depozitat 1-mujore;
- Normat e interesit për huatë në lekë ishin 5.70 përqind për huatë 12-mujore dhe 5.56 përqind për ato 6-mujore;
- Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1,610,613.0 milionë lekë në muajin Qershor, duke shënuar një rritje prej rreth 7.3 përqind, krahasuar me një vit më parë;
- Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e parë të 2022 rezultoi me rritje të mjeteve valutore (rezervës), duke shënuar vlerën 89.1 milionë euro
- Situata Buxhetore për periudhën Qershor 2022 rezultoi me një sufiçit të përgjithshëm prej rreth 15.201 miliardë lekë, ndërkohë që ishte planifikuar një defiçit prej 33.472 miliardë lekë.
- Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Qershor 2022, arritën në rreth 279.410 miliardë lekë ose afërsisht 5.6% më shumë se plani për këtë periudhë.
- Shpenzimet gjithsej gjatë së njëjtës periudhë, arritën në rreth 264.210 miliardë lekë ose rreth 11.4% më pak se shpenzimet e planifikuara për këtë periudhë.

Zhvillimet Ekonomike

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Inflacioni vjetor për muajin Qershor 2022 ishte 7.4%, një vit më parë ky ndryshim ishte 1.6%. Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Qershor 2022, krahasuar me Maj 2022 është -0.1%. Një muaj më parë, Maj 2022, IÇK shënoi rënie mujore gjithashtu prej 0.5%.

Referuar një viti më parë, Indeksi i Çmimeve të Konsumit për muajin Qershor 2021 shënoi rritje mujore prej 0.8%, në krahasim me muajin paraardhës.



Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, grupet të cilat patën kontributin më të lartë në inflacionin e përgjithshëm ishin:

- “Ushqime dhe pije joalkolike” me rritje vjetore të çmimit prej +12.6%, duke kontribuar me +4.36 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +7.4%.
- “Transport” me rritje vjetore të çmimit prej +26.9%, duke kontribuar me +1.53 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +7.4%.
- “Qera, ujë lëndë djegëse dhe energji” me rritje vjetore të çmimit prej +2.8%, duke

- kontribuar me +0.54 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +7.4%.
- “Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje”, me rritje vjetore +3.8%, duke kontribuar me +0.28 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +7.4%.
- “Hotele, kafene dhe restorante” me rritje vjetore të çmimit prej +5.5%, duke kontribuar me +0.25 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +7.4%.

Tab - 1 Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)

VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2021	0.4	1.1	1.2	1.4	1.8	1.6	2.2	2.4	2.5	2.4	3.1	3.7
2022	3.7	3.9	5.7	6.2	6.7	7.4						

Burimi: INSTAT


2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin Qershor 2022, arriti në 119.8 lekë/euro, duke shënuar rënie në vlerë me 0.56 përqind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit Qershor, një euro u këmbye me 119.13 lekë.

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin Qershor 2022 arriti në 113.25 lekë/dollarë duke shënuar rënie në vlerë me 0.61 përqind kundrejt një muaji më parë. Në fund të muajit Qershor, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 114.22 lekë/dollarë.

Në krahasim me muajin Qershor të vitit të kaluar, pas një periudhe të konsiderueshme forcimi, rezulton se monedha shqiptare ka pësuar një mbiçmim ndaj monedhës europiane në masën 2.47 përqind, ndërsa kundrejt dollarit amerikan rezulton se është nënçmuar në masën 11.11 përqind. Në përgjithësi, forcimi i lekut në vitet e fundit ka ardhur si pasojë e konjunkturave të jashtëme, për shkak të krizave të njëpasnjëshme, nga pandemia botërore Covid-19 deri tek lufta në Ukrainë.

Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan, shënoi një nivel mesatar rreth 0.95 dollarë/euro për muajin Qershor 2022.




Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë kësaj periudhe përmendim: qëndrueshmëria e kursit të këmbimit për shkak të ndërhyrjes së shpejtë të BSH-së, stabiliteti i situatës makroekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasiteti në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarrja nga BSH-ja, etj.

3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave


Gjatë muajit Qershor 2022, normat e interesit të depozitave me afat 12 dhe 1 mujore shënuan vlerat më të larta prej 0.65 dhe 0.92 përqind përkatësisht, pasuar nga ato me afat 6 dhe 3 mujore që arritën kuotën 0.42 dhe 0.22 përqind përkatësisht.

Krahasuar me një muaj më parë, normat e interesit të depozitave me afat maturimi 6 mujore kanë shënuar rritje me 0.08 ndërsa ato 1 mujore kanë shënuar rënie me 0.02 pikë përqindje. Normat e interesit të depozitave me afat 12 mujore kanë shënuar rritje me 0.65 pikë përqindje.

Referuar një viti më parë, normat e interesit të depozitave me afat maturimi 12,6,3 dhe 1 mujore kanë shënuar rritje vjetore përkatësisht prej 0.16 , 0.13, 0.06 dhe 0.52 pikë përqindje.



Normat e Interesit të huave 6 dhe 12 mujore, gjatë muajit Qershor 2022, arritën përkatësisht kuotën prej 5.56 dhe 5.70 përqind. Në krahasim me një muaj më parë, normat e interesit të huave 6 dhe 12 mujore kanë shënuar rënie me 0.65 dhe 1.05 pikë përqindje. Krahasuar me një vit më parë normat e interesit të huave 6 dhe 12 mujore kanë shënuar rënie vjetore përkatësisht me 0.20 dhe 0.19 pikë përqindje.



Normat e interesit të bonove të thesarit 12 mujore për muajin Qershor 2022 patën rritje vjetore me 1.01 pikë përqindje.



4. Bilanci i Pagesave

Përgjatë vitit 2021, Bilanci i Pagesave u zgjerua, duke shënuar vlerën 936 milion euro, nga 655 milion euro që ishte një vit më parë (2020). Gjithashtu, vetëm për tremujorin e parë të 2022, BP shënoi vlerën -527.5 milion euro, krahasuar me tremujorin e parë të 2021 që shënoi vlerën 74.5 milion euro.

Përgjatë vitit 2021, deficioni i llogarisë korente pati një zgjerim të lehtë në -1,186 miliardë euro krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë që ishte -1,153 miliardë euro. Po ashtu, vetëm për tremujorin e parë të 2022, llogaria korente e zgjeroi deficitin në -232.8 milion euro, krahasuar me tremujorin e parë të 2021 që ishte -297.6 milion euro.

Përgjatë vitit 2021, llogaria financiare dhe kapitale u zgjerua në vlerën +1,913 miliardë euro krahasuar me +1,648 miliardë euro në vitin 2020. Gjithashtu, vetëm për tremujorin e parë të 2022, llogaria financiare dhe kapitale e zgjeroi deficionin në -214.5 miliardë euro, krahasuar me tremujorin e parë të 2021 + 414.5 miliardë euro.

Përgjatë vitit 2021, të hyrat nga shërbimet të lidhura përgjithësisht me Turizmin u zgjeruan në vlerën +1,912 miliardë euro. Gjithashtu, vetëm për tremujorin e parë të 2022 të hyrat nga shërbimet të lidhura përgjithësisht me Turizmin u zgjeruan në vlerën 408.8 milion euro, krahasuar me tremujorin e parë të 2021 + 239.8 milion euro.





5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit Qershor 2022, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), me rreth 85.674 milionë lekë krahasuar me muajin Qershor të vitit 2021. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto të Bankës Qëndrore me 83.555 milionë lekë. Krahasuar me një muaj më parë mjetet valutore neto kanë shënuar rritje me 2.693 milionë lekë, ku më së shumti ka kontribuar rritja mujore prej 5.102 milionë lekë e Bankave Paradeponituese.

Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1,610,613 milionë lekë në muajin Qershor 2022, duke shënuar një rritje prej rreth 108.999 milionë lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, pra një rritje vjetore prej 7.3 përqind.

Në muajin Qershor 2022, sistemi bankar rezultoi me rritje mujore prej 14.0534 milionë lekë.





6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë për muajin Qershor 2022 arriti në rreth 701.531 milionë lekë. Bilanci i kredisë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shënoi rritje me vlerë 76.745 milionë lekë, ose rritje me rreth 12.28 përqind. Struktura e kredisë sipas monedhave është e balancuar mes monedhës kombëtare (51.9%) dhe monedhave të huaja (48.1%).


Gjatë muajit Qershor 2022, zëri “Korporata të tjera jo-financiare”, zuri peshën më të lartë të totalit të kredive, me rreth 58.4 përqind ose 409.447 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 35.31 përqind ose rreth 251.970 milionë lekë. Zërat “Korporata jo financiare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 3.51 dhe 1.98 përqind apo 24.716 dhe 15,217 milionë lekë.

Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës së huaj për muajin maj 2022, zëri “Korporata të tjera jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 69.46 përqind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 24.18 përqind. “Korporata të tjera financiare” dhe “Korporata jofinanciare publike” kontribuojnë përkatësisht me 1.92 dhe 4.21 përqind secili.




7. Oferta e Parasë

Paraja jashtë Korporatave Depozituese arriti në rreth 371.027 milionë lekë në fund të muajit Qershor 2022. Raporti i Parasë jashtë Bankave me M3 në Qershor 2022 ka shënuar rënie mujore prej 0.01 përqind dhe rënie vjetore prej 0.60 përqind, duke arritur nivelin 23.04 përqind. Raporti i Parasë jashtë Bankave me Depozitat ka shënuar rënie mujore prej 0.02 përqind, dhe rënie vjetore prej 1.03 përqind, duke shënuar nivelin 29.9 përqind.




Depozitat në valutë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin Qershor 2022, kanë shënuar rritje vjetore prej 78.279 milionë lekë, e sjellë kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 75.9 përqind të depozitave në valutë. Gjithashtu depozitat në Lekë gjatë muajit Qershor 2022 shënuan rritje prej 14.680 milionë lekë në krahasim me muajin Qershor 2021. Sektori i Individëve në lekë ka zënë rreth 80.4 përqind të depozitave në lekë.




8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit Qershor 2022, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 80.4 përqind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 14.7 përqind dhe nga “Korporata jo-financiare publike” me 3.2 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 75.9 përqind dhe rreth 21.6 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 77.8 përqind e totalit.



Në total, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 964.737 milionë lekë të depozitave totale. Ato ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (230.325 milionë lekë), “Korporata të tjera financiare” (21.445 milionë lekë), dhe “Korporata jofinanciare publike” (21.672 milionë lekë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth (1.405 milionë lekë) në totalin e depozitave. Gjatë muajit Qershor 2022, niveli i përgjithshëm i depozitave arriti vlerën rreth 1,239,585 milionë lekë.




Krahasuar me një muaj më parë niveli i depozitave shënoi rritje prej rreth 11.035 milionë lekë. Ndërsa, krahasuar me një vit më parë totali i depozitave ka shënuar rritje me 92.959 milionë lekë.

Sektori Fiskal

1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën Qershor 2022 janë mbledhur rreth 279.410 miliardë lekë të ardhura, përkundrajt shpenzimeve të përgjithshme prej 264.210 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 226.330 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe rreth 101.839 miliardë lekë në shpenzime për fonde speciale.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 264.719 miliardë lekë. Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor janë rreth 16.852 miliardë lekë (ose 8.7 % më shumë se me planin e periudhës). Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 59.147 miliardë lekë (ose rreth 4.5 % më shumë se plani i periudhës) dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin 11.866 miliardë lekë.



Nga totali i shpenzimeve korrente prej 226.330 miliardë lekë, 40.992 miliardë lekë (18.11 % e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 19.117 miliardë lekë (8.44 % e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzime interesi, 25.512 miliardë leke (11.27 % e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 483 milionë lekë (0.21% e totalit të shpenzimeve korrente) për subvencione, 101.839 miliardë lekë (44.99 %) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, 24.735 miliardë lekë (10.92% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzimet e qeverisjes vendore, dhe 13.651 miliardë lekë (6.03% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzimet tjera.

2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Qershor 2022 ishin rreth 234.320 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 219.009 miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 11.465 miliardë lekë.

Tab - 2	Të ardhurat gjatë muajit Janar – Qershor 2022 (mld Lekë) Revenues during January - June 2022 (in billion ALL)			
	Burimi (Source)	June '22 Qershor '22	June '21 Qershor '21	Ndrysh(%) Chang (%)
	TVSH (VAT)	91,129	68,406	+ 33.2
	Taksa doganore (Custom Tax)	3,905	3,322	+ 17.5
	Akcizat (Excise)	24,184	23,176	+ 4.4
	Tatimi mbi fitimin (Profit Tax)	24,914	17,653	+ 41.1
	Tatim mbi të ardhurat personale (TAP) / (Income Tax)	21,612	19,120	+ 13.0
	Taksat nacionale (National Tax)	22,975	19,434	+ 18.2

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Statistikat Fiskale: Qershor - 2022

Source: Ministry of Finance and Economy, Fiscal Statistics: June - 2022

3. Financimi i Bilancit Fiskal

Bilanci fiskal për mujin Qershor 2022 ka vlerën 15.201 miliardë lekë.

Për periudhën Janar-Qershor 2022, disa nga treguesit kryesorë fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 279.410 miliardë lekë,
- Realizimi i shpenzimeve në masën 264.210 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave për periudhën Janar - Qershor 2022, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat tatimore, të cilat arrijnë shifrën e 264.719 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 226.330 miliardë lekë dhe shpenzimet për fonde speciale me rreth 101.839 miliardë lekë.

Aneksi Statistikor

Tab - 1 Indeksi i çmimeve të konsumit
Consumer price index (in %)

Muaji	Mujor (Monthly)							Mesatar Mujor (Monthly Average)							Vjetor (Annual)							Month
	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	
Janar	0.9	1.5	1.5	1.6	1.9	1.3	1.3	0.9	1.5	1.5	1.6	1.9	1.3	1.3	1.5	2.8	1.7	1.9	1.5	0.4	3.7	January
Shkurt	1.1	0.5	0.8	0.6	0.4	1.1	1.3	1.0	1.0	1.1	1.1	1.1	1.2	1.3	0.2	2.2	2.1	1.7	1.2	1.1	3.9	February
Mars	0.5	0.4	0.3	-0.3	0.6	0.7	2.4	0.8	0.8	0.9	0.6	0.9	1.0	1.7	0.3	2.1	2.0	1.1	2.1	1.2	5.7	March
Prill	-0.4	-0.6	-0.5	-0.2	-0.4	0.2	0.7	0.5	0.5	0.5	0.4	0.6	0.8	1.4	0.3	1.9	2.1	1.4	1.9	1.9	6.2	April
Maj	-1.2	-1.2	-1.2	-1.0	-0.8	-0.9	-0.5	0.2	0.1	0.2	0.1	0.3	0.5	1.0	0.7	2.0	2.1	1.5	2.1	1.8	6.7	May
Qershor	-0.6	-0.4	-0.1	-0.3	-0.6	-0.8	-0.1	0.04	0.0	0.1	0.1	0.2	0.3	0.9	1.2	2.2	2.4	1.3	1.8	1.6	7.4	June
Korrik	0.0	-0.1	-0.3	-0.1	-0.5	0.1		0.04	0.0	0.1	0.0	0.1	0.2		1.9	2.0	2.3	1.5	1.4	2.2		July
Gusht	0.9	0.4	0.4	0.3	0.2	0.4		0.14	0.1	0.1	0.1	0.1	0.3		2.0	1.6	2.2	1.5	1.3	2.4		August
Shtator	0.4	0.4	0.2	0.1	0.4	0.5		0.17	0.1	0.1	0.1	0.1	0.3		1.8	1.6	2.1	1.3	1.5	2.5		September
Tetor	-0.2	0.0	-0.2	-0.2	0.2	0.1		0.04	-0.1	-0.1	-0.1	0.1	0.3		1.8	1.6	2.1	1.3	2.0	2.4		October
Nëntor	0.1	-0.1	-0.2	-0.2	-0.5	0.2		0.12	0.1	0.1	0.0	0.1	0.3		1.9	1.7	1.8	1.4	1.6	3.1		November
Dhjetor	0.1	-0.1	-0.2	-0.2	0.3	0.8		0.05	-0.1	-0.1	-0.1	0.1	0.3		1.9	1.7	1.8	1.4	1.1	3.7		December

Burimi : INSTAT

Source : INSTAT

Tab - 2 **Kursi i këmbimit**
Exchange rate

Monedha	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022 Janar January	2022 Shkurt February	2022 Mars March	2022 Prill April	2022 Maj May	2022 Qershor June	Currency
Mesatarja e periudhës														Average of period
USD	125.96	124.15	119.10	107.99	109.85	108.65	103.68	107.32	107.02	111.58	111.69	113.94	113.25	USD
EURO	139.74	137.36	134.15	127.59	123.01	123.77	122.37	121.49	121.32	122.96	121.00	120.47	119.80	EURO
Fundi i periudhës														In the end of period
USD	125.79	128.17	111.10	107.82	108.64	100.84	106.54	108.18	108.52	109.28	114.56	112.51	114.22	USD
EURO	137.28	135.23	132.95	123.42	121.77	123.70	120.76	120.90	121.32	121.62	121.10	120.75	119.13	EURO

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 3

Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)

Annual Interest Rates (in ALL)

Në përqindje	2018	2019	2020	2021	2022	2022	2022	2022	2022	2022	In percent
					Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	
Norma e depozitave											Deposits rates
12-M	0.73	0.49	0.41	0.47	0.44	0.46	0.46	0.80	0.75	0.65	12-M
6-M	0.59	0.42	0.35	0.35	0.35	0.27	0.30	0.34	0.50	0.42	6-M
3-M	0.28	0.23	0.21	0.15	0.15	0.13	0.16	0.39	0.23	0.22	3-M
1-M	0.76	0.66	0.49	0.41	0.39	0.38	0.48	0.79	0.90	0.92	1-M
Norma e huasë											Lending rates
12-M	5.66	6.25	6.05	5.91	6.56	6.40	6.01	6.69	6.57	5.70	12-M
6-M	8.12	7.07	6.28	6.16	5.82	6.78	6.55	9.37	6.21	5.56	6-M
Norma e letrave me vlerë											Securities rates
Bono thesari 1/											Treasury bills 1/
3-M	-	-	-		0.96	0.85	1.00	1.40	1.26	1.50	3-M
6-M	-	-	-			1.21	1.24	1.75	1.85	-	6-M
12-M	1.43	1.69	1.77	1.60	1.58	1.58	1.87	1.96	2.16	2.50	12-M

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

TREGUESIT FISKAL SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2022

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2022

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

Nr.	E M È R T I M I	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	ITEMS
	TOTALI TË ARDHURAVE	45,726	87,679	139,408	188,172	233,421	279,410	TOTAL REVENUE
I.	Të ardhura nga ndihmat	189	1,000	1,782	2,167	2,707	2,825	Grants
II.	Të ardhura tatimore	44,054	83,482	132,519	178,083	220,614	264,719	Tax Revenue
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	30,038	57,882	95,732	126,505	156,870	188,719	From tax offices and customs
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	15,075	29,586	45,639	60,821	75,943	91,129	V.A.T
2	Tatimi mbi Fitimin	1,652	3,992	14,277	17,949	20,765	24,914	Profit Tax
3	Akcizat	3,495	7,463	11,367	15,087	19,476	24,184	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	4,028	7,099	10,569	14,666	18,264	21,612	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	5,324	8,714	12,152	15,610	19,294	22,975	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	464	1,029	1,728	2,372	3,128	3,905	Customs Duties
II.2	Të ardhura nga Pushteti Vendor	3,166	5,790	7,753	11,546	14,098	16,852	Revenues from Local Gov.
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat)	277	557	1,065	2,208	2,958	3,659	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	9	15	25	31	38	40	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	2,880	5,218	6,664	9,307	11,102	13,153	Local Taxes
II.3	Të ardh nga fondet speciale	10,850	19,811	29,033	40,032	49,645	59,147	Social ins. contributions
1	Sigurimi Shoqëror	9,312	17,055	25,008	34,393	42,707	50,901	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetsor	1,500	2,651	3,831	5,352	6,579	7,801	Health Insurance
3	Të ardhura për kompensim në vlerë të pronarëve	38	105	194	287	360	446	Compensation income in the value of owners
III.	Të ardhura Jotatimore	1,484	3,197	5,108	7,922	10,101	11,866	Nontax Revenue
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë	0	0	0	0	0	0	Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	942	2,058	3,325	5,309	6,772	7,765	Income of budgetary institutions
3	Tarifat shërbimeve	188	354	555	784	996	1,297	Utility fees
4	Të tjera	354	785	1,227	1,829	2,333	2,803	Others
	TOTALI I SHPENZIMEVE	32,599	68,920	117,523	169,201	214,131	264,210	TOTAL EXPENDITURE
I.	Shpenzime Korrente	31,895	67,325	104,161	145,133	183,265	226,330	Current Expenditures
I.1	Personeli	6,740	13,486	20,333	27,169	34,079	40,992	Personnel expenditures
1	Paga	5,781	11,564	17,428	23,279	29,203	35,084	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqërore	952	1,906	2,859	3,831	4,787	5,791	Social insurance contributions
3	Arsimi I larte nga te ardhurat e veta	6	17	46	60	89	118	Higher education from its own income
I.2	Interesat	5,037	7,446	11,029	13,668	15,161	19,117	Interest
1	Të Brendshme	4,010	5,907	8,947	10,895	11,775	12,599	Domestic
2	Të Huaja	1,027	1,539	2,082	2,773	3,387	6,519	Foreign
I.3	Shpenzime Operative Mirëmbajtje	1,732	5,776	9,920	15,048	20,169	25,512	Operational & Maintenance
I.4	Subveconet	74	167	252	329	412	483	Subsidies
I.5	Shpenzime për fonde speciale	14,449	30,212	45,532	64,692	82,264	101,839	Social Insurance outlays
1	Sigurime Shoqërore	10,645	21,559	33,340	46,934	60,422	75,499	Social insurance
2	Sigurime Shëndetsore	3,129	7,979	11,515	16,531	20,616	25,115	Health insurance
3	Fondi I kompensimit të pronarëve	674	674	677	1,227	1,226	1,226	Owners' Compensation Fund
I.6	Shpenzime per Buxhetin Vendor	2,457	6,764	11,130	15,671	20,089	24,735	Local budget expenditure
I.7	Shpenzime të tjera	1,407	3,473	5,964	8,555	11,090	13,651	Other expenditures
1	Pagesa e Papunesisë	45	109	175	233	297	361	Unemployment insurance benefits
2	Ndihma Ekonomike	1,162	2,891	5,017	7,258	9,463	11,598	Economic Aid
3	Bonusi I lindjeve	200	400	700	900	1,100	1,400	Birth bonus
I.8	Transferime Kapitale	0	0	0	0	0	0	Capital transfers
II	Fondi Rezerve, Kontigjenca	0	0	0	0	0	0	Reserve fund/contingency
III	Shpenzime Kapitale	703	1,596	7,986	16,161	22,959	29,972	Capital expenditures
1	Financimi Brendshëm	0	175	2,653	5,620	8,213	11,942	Domestically financing
2	Investime nga te ardhurat e Arsimit te Lartë	1	26	97	173	262	354	From higher education system's own revenues
3	Financimi Huaj	703	1,395	4,043	5,090	6,989	8,178	Foreign financed
IV	Fondi I rindertimit	0	0	1,193	5,278	7,494	9,497	Reconstruction fund
V.	DEFICITI	13,127	18,759	21,885	18,971	19,290	15,201	CASH BALANCE
V.1	FINANCIMI DEFICITIT	-13,127	-18,759	-21,885	-18,971	-19,290	-15,201	CASH BALANCE FINANCING
V.2	Brendshëm	-12,150	-14,220	-21,203	-12,981	-12,307	-14,037	Domestic
1	Të ardhura nga privatizimi	44	55	59	98	131	133	Privatization receipts
2	Hua-marrje e brendshme	2,604	-4,986	-1,789	-8,710	-7,124	-2,895	Domestic new borrowing (net)
3	Të tjera	-14,798	-9,290	-19,473	-4,369	-5,314	-11,275	Others
V.3	I huaj	-977	-4,539	-682	-5,990	-6,984	-1,164	Foreign
1	Hua afatgjatë(e marrë)	420	2,490	3,472	3,821	5,162	6,193	Long-term foreign borrowing (gross)
2	Ndryshimi i gjendjes së arkës*	114	-2,048	-1,132	-814	-752	-674	Chang. of stat. Account
3	Ripagesat	-1,511	-4,981	-8,184	-14,445	-17,179	-20,589	Repayments
4	Mbështetje Buxhetore	0	0	5,161	5,448	5,786	13,906	Budgetary Support

Burimi : Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Source : Ministry of Finance and Economy

Tab - 5

Tabela e investimeve 2022

Table of investments 2022

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	
	January	February	March	April	May	June	
Financim i brendshëm	-12,150	-14,220	-21,203	-12,981	-12,307	-14,037	Domestic financing
Në %	92.6	75.8	96.9	68.4	63.8	92.3	In %
Financim i huaj	-977	-4,539	-682	-5,990	-6,984	-1,164	Foreign financing
Në %	7.4	24.2	3.1	31.6	36.2	7.7	In %
Totali	-13,127	-18,759	-21,885	-18,971	-19,290	-15,201	Total
Në %	100	100	100	100	100	100	In %

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Source: Ministry of Finance and Economy

Tab - 6 TË ARDHURAT DOGANORE DHE TATIMORE 2022
CUSTOMS AND TAX REVENUES 2022

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	
Taksë doganore	464	1,029	1,728	2,372	3,128	3,905	Customs Duties
TVSH	9,160	20,475	34,070	46,579	59,299	72,542	V.A.T
Akcizë	3,495	7,463	11,367	15,087	19,476	24,184	Excises
Të tjera (Renta Minerare)	277	603	1,105	1,449	1,885	2,313	Others (Mineral Rent)
TOTALI	13,397	29,570	48,270	65,487	83,789	102,944	Total

TË ARDHURAT TATIMORE 2022 (TAX REVENUE)

TVSH	5,915	9,110	11,569	14,242	16,644	18,586	V.A.T
Tatim mbi fitimin	1,652	3,992	14,277	17,949	20,765	24,914	Profit Tax
Tatimi mbi të ardhurat personale	4,028	7,099	10,569	14,666	18,264	21,612	Personal income tax
Taksa nacionale dhe të tjera	5,047	8,111	11,048	14,162	17,409	20,662	National taxes
TOTALI	16,641	28,312	47,462	61,019	73,082	85,775	Total
TOTALI I PËRGJITHSHËM	30,037	57,882	95,732	126,505	156,871	188,719	OVERALL TOTAL

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Tab - 7

DEFICITI DHE FINANCIMI PËR 2022

The Deficit and Its Financing for 2022

Të dhëna progresive (Progresive Data)

Në milionë lekë (In million ALL)

	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	
TË ARDHURAT	45,726	87,679	139,408	188,172	233,421	279,410	REVENUE
SHPENZIMET	32,599	68,920	117,523	169,201	214,131	264,210	EXPENDITURES
BILANCI FISKAL	13,127	18,759	21,885	18,971	19,290	15,201	FISCAL BALANCE
FINANCIMI I BILANCIT FISKAL	-13,127	-18,759	-21,885	-18,971	-19,290	-15,201	FINANCING
Financimi i brendshëm	-12,150	-14,220	-21,203	-12,981	-12,307	-14,037	Domestic
Të ardhura nga privatizimi	44	55	59	98	131	133	Privatization receipts
Hua-marrje e brendshme	2,604	-4,986	-1,789	-8,710	-7,124	-2,895	Domestic borrowing
Të tjera	-14,798	-9,290	-19,473	-4,369	-5,314	-11,275	Others
Financimi i jashtëm	-977	-4,539	-682	-5,990	-6,984	-1,164	Foreign
a. Hua afatgjatë	420	2,490	3,472	3,821	5,162	6,193	Long-term foreign borrowing (gross)
b. Ripagesat	114	-2,048	-8,184	-14,445	-17,179	-20,589	Chang. of stat. Account
c. Ndryshimi I gjëndjes së arkës	-1,511	-4,981	-1,132	-814	-752	-674	Repayments
d. Mbeshtetje Buxhetore			5,161	5,448	5,786	13,906	Budgetary Support

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Source: Ministry of Finance and Economy

BILANCI I PAGESAVE

Balance of payments

Në milion Euro

In millions Euro

	2017	2018	2019	2020	2021	3M_I_2022	
Llogaria korente	-865.90	-866.40	-1,088.70	-1,152.73	-1,186.26	-232.75	Current Account.
Bilanci tregtar	-2,824.10	-2,871.10	-3,143.80	-2,982.51	-3,829.34	-815.97	Trade Balance.
Eksporti I mallrave fob	797.10	986.10	906.50	793.63	1,264.79	482.59	Merchandise Exports. Fob
Importi I mallrave fob	-3,621.20	-3,857.20	-4,050.30	-3,776.14	-5,094.13	1,298.56	Merchandise Imports. Fob
Bilanci i shërbimeve	1,081.90	1,111.00	1,263.90	1,051.72	1,776.10	405.47	Services Balance.
Shërbimet Kredi	2,856.20	3,072.80	3,404.60	2,226.22	3,466.03	861.22	Services Credit
Shërbimet Debi	1,774.30	1,961.80	2,140.70	1,174.50	1,689.93	455.75	Services Debt
Bilanci i të ardhurave	28.60	-13.80	-180.10	-219.34	-210.98	-65.59	Balance of Incomes
Të ardhurat Kredi	407.40	392.80	420.20	337.10	397.57	107.27	Income Credit
Të ardhurat Debi	-378.80	-406.60	-600.30	-556.44	-608.55	172.86	Income Debt
Bilanci i transfertave	847.70	907.50	971.30	997.40	1,077.96	243.33	Balance of Transfers
Transferta private	961.80	1,005.40	1,105.50	1,169.70	1,244.00	284.12	Private Unrequired Transfers
Transfertat shtetërore	-114.10	-97.90	-134.20	-172.30	-166.04	40.78	Official Unrequired Transfers
Llogaria kapitale	122.30	104.00	76.10	143.60	358.46	9.54	Capital Account
Llogaria financiare	-1,115.30	-1,142.60	-827.00	-1,504.31	-1,554.51	-214.51	Financial Account
Investime direkte	-993.80	-1,022.20	-1,036.30	-893.56	-989.93	-252.77	Direct Investment
Investime portofoli	-100.00	-76.10	140.60	-65.85	-83.95	126.38	Portfolio Investment
Kapitale të tjera	49.00	-50.40	50.90	-403.80	-534.17	-107.77	Other Capital
Gabime dhe harresa neto	-186.30	-8.70	107.90	159.33	209.47	-80.25	Net errors and omissions
Bilanci i përgjithshëm	185.40	371.50	-77.70	654.51	936.18	-88.95	Overall Balance
Rezervat	185.40	371.50	-77.70	654.70	936.17	-88.94	Reserve Assets
Përdor kred & huash nga FMN	70.50	-6.10	-17.80	141.10	-53.54	-19.65	Use of Fund Credit and Loans

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

MJETET VALUTORE NETO

Net Foreign Assets

Në milionë Lekë	2019	2020	2021	2022	2022	2022	2022	2022	Millions of Lek
Fundi i periudhes				Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	End of Period
				February	March	April	May	June	
Mjete valutore neto	733,114	803,487	937,814	932,896	923,549	916,576	906,171	908,864	Net foreign assets
Pretendime ndaj jorezidentëve	794,006	860,750	1,027,069	1,025,224	1,017,093	1,012,149	1,003,238	1,006,477	Claims on nonresidents
Minus Detyrime të jorezidentëve	60,892	57,263	89,255	92,328	93,543	95,573	97,067	97,613	Minus: Liabilities to nonresidents
Mjetet e brendshme	950,426	1,047,835	1,084,106	1,096,426	1,109,457	1,122,468	1,133,376	1,138,170	Domestic assets
Pretendimet neto ndaj qeverisë qendrore	378,524	435,613	412,253	416,444	420,216	426,551	431,189	430,242	Net claims on central government
Pretendime ndaj sektoreve të tjera	571,902	612,221	671,852	679,982	689,241	695,917	547,261	549,281	Claims on other sectors
Detyrimet e parasë së gjërë	1,318,662	1,456,993	1,582,310	1,592,296	1,593,358	1,596,554	1,596,559	1,610,772	Broad Money liabilities
Paraja jashtë Korporatave Depozituese	291,409	344,560	366,251	363,289	365,989	368,311	368,009	371,030	Money outside depository corporations
Depozita të transferueshme	408,780	490,394	584,631	589,063	590,239	593,383	595,816	608,590	Transferable deposits
Depozita të tjera	618,473	622,039	631,428	639,944	637,131	634,860	632,734	631,152	Other deposits
Depozita të papërfshira në parandë e gjërë	178,375	186,892	222,409	217,705	218,014	220,419	224,744	226,052	Deposits excluded from Broad Money
Qeveria lokale dhe administrata publike									Local government and public administration
Korporata të tjera financiare	3,879	4,666	5,877	5,970	5,923	5,810	7,506	7,965	Other financial corporations
Korporata jofinanciare publike	336	252	392	383	388	423	384	376	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	8,238	6,925	16,599	9,149	9,855	9,819	9,996	9,856	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	165,922	175,050	199,541	202,202	201,848	204,367	206,678	207,856	Other resident sectors
Letrat me vlerë të ndryshme nga aksionet	6,656	5,926	7,288	6,885	7,534	7,567	7,561	7,518	Securities other than shares
Korporata të tjera jofinanciare	101	57	67	125	208	210	210	211	Korporata të tjera jofinanciare
Sektorë të tjerë rezidentë	6,555	5,869	7,221	6,760	7,326	7,357	7,351	7,306	Other resident sectors
Huatë	2,527	3,757	3,507	3,073	4,915	5,504	5,500	4,652	Loans
Qeveria lokale dhe administrata publike									Local government and public administration
Korporata të tjera financiare	2,527	3,757	3,507	3,073	4,915	5,504	5,500	4,652	Other financial corporations
Korporata jofinanciare publike									Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera jofinanciare									Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë									other resident sectors
Llogari të pagueshme	229	62	248	233	271	210	132	487	Accounts payable
Korporata të tjera Financiare									Other financial corporations
Korporata jofinanciare publike									Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	1	5		7		0	0	358	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	229	57	247	226	270	209	132	129	other resident sectors
Aksione dhe instrumenta të tjerë të kapitalit	200,257	214,394	219,725	220,484	215,973	218,661	214,221	206,843	Shares and other equity
Nga të cilat rezerva rivlerësimi	-2,652	-1,095	-5,442	-6,759	-11,270	-9,463	-14,224	-20,487	Of which: Valuation adjustment
Të tjera neto	-23,895	-17,621	-14,428	-13,038	-10,327	-11,731	-11,021	-10,948	Other items net
Detyrime të tjera	50,220	55,892	59,094	60,726	63,196	62,202	62,362	62,270	Other liabilities
Minus: Mjete të tjera	74,115	73,514	73,521	73,764	73,523	73,933	73,383	73,219	Minus: Other assets
Axhustimi i konsolidimit	729	919.0	862	1,686	3,268	1,861	1,850	1,655	Consolidation adjustment

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab -
10 **KREDIA PËR EKONOMINË**
Credit to Economy

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2019	2020	2021	2022 Shkurt February	2022 Mars March	2022 Prill April	2022 Maj May	2022 Qershor June	Million of Lek End of Period
Totali i kredisë	570,792.2	608,779.8	666,178.4	674,305.1	683,563.0	689,993.6	696,267.5	701,530.8	Total Credit
Kredia për qeverinë lokale dhe administratën publike	560.6	429.1	313.2	205.5	200.0	193.9	186.8	180.9	Credits to local Government
Në lekë	560.6	429.1	313.2	205.5	200.0	193.9	186.8	180.9	in Lek
Në valutë	-	-	-	-	-	-	-	-	in Foreign Currency
Kredia për korporatat jofinanciare publike	24,182.4	15,150.8	22,521.8	23,276.1	24,510.0	23,406.1	24,621.4	24,715.9	Credits to Public Non-financial Corporations
Në lekë	18,489.7	11,819.6	9,210.6	10,228.9	10,380.0	10,198.1	10,416.5	10,905.9	in Lek
Në valutë	5,692.7	3,331.2	13,311.3	13,047.2	14,130.0	13,208.0	14,204.9	13,810.0	in Foreign Currency
Kredia për korporatat e tjera jofinanciare	335,884.5	370,356.3	395,162.7	399,605.7	403,166.0	408,934.3	409,824.8	409,447.1	Credits to other Non-financial Corporations
Në lekë	141,240.5	161,975.3	172,000.2	173,010.8	172,641.0	174,215.9	175,201.4	175,477.1	in Lek
Në valutë	194,644.1	208,381.0	223,162.5	226,595.0	230,524.0	234,178.4	234,623.4	233,970.0	in Foreign Currency
Kredia për korporatat e tjera financiare	13,555.1	13,169.1	13,815.7	13,588.0	13,642.0	13,714.0	13,908.5	15,217.3	Credits to Other Financial Corporations
Në lekë	8,023.8	7,489.2	7,772.8	7,151.6	7,271.0	7,100.5	7,426.9	8,183.3	in Lek
Në valutë	5,531.3	5,679.9	6,043.0	6,436.4	6,371.0	6,613.5	6,481.6	7,034.0	in Foreign Currency
Kredia për sektorë të tjerë rezidentë	196,609.5	209,674.5	234,365.0	237,629.8	242,045.0	244,285.2	247,726.0	251,969.8	Credits to other resident sectors
Në lekë	130,409.2	138,986.4	158,093.0	159,793.9	162,267.0	163,819.4	166,083.8	169,192.1	in Lek
Në valutë	66,200.3	70,688.1	76,272.0	77,835.9	79,778.0	80,465.8	81,642.2	82,777.7	in Foreign Currency

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 11 **OFERTA E PARASË**
Money Supply

Mujor-Monthly

Në milion Lekë	2021	2022	2022	2022	2022	2022	2022	
Fundi i periudhës		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Millions of LEK
		January	February	March	April	May	June	End of Period
Baza monetare	565,163	557,155	566,146	561,563	563,058	569,567	569,816	Monetary base
Paraja jashtë korporatave depozituese	366,251	362,841	363,289	365,989	368,310	368,009	371,028	Currency outside depository corporations
Agregati M1	701,404	699,228	695,465	694,568	693,939	694,521	703,254	M1 Aggregate
Agregati M2	918,474	915,120	910,349	907,331	906,222	905,902	914,557	M2 Aggregate

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

DEPOZITAT

Deposits

Mujor-Monthly

Në milionë Lekë	2021	2022	2022	2022	2022	2022	2022	Millions of Leks
Fundi i periudhës		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	End of Period
		January	February	March	April	May	June	
Totali i depozitave	1,216,059	1,234,394	1,229,007	1,227,370	1,228,243	1,228,550	1,239,585	Total of deposits
Në lekë	552,223	552,279	547,060	541,342	537,911	537,892	543,529	In national currency
Depozitat e transferueshme	276,074	275,246	270,240	267,355	264,962	265,738	271,714	Transferable deposits
Qeveria lokale dhe administrata publike	1,302	1,430	1,361	1,333	1,255	1,327	1,360	Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	17,118	13,343	13,639	13,987	13,749	13,657	13,784	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	4,744	4,683	4,248	4,968	3,980	3,836	3,835	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	77,758	80,228	73,780	71,284	68,228	69,392	70,779	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	175,154	175,560	177,211	175,783	177,749	177,526	181,956	Other resident sectors
Depozita me likuiditet të lartë (Depozita pa afat)	59,079	61,142	61,936	61,225	60,667	60,774	60,512	Liquid deposits (Sight deposits)
Qeveria lokale dhe administrata publike								Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	1,762	2,772	2,767	2,802	2,800	2,796	2,805	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	78	78	78	78	78	78	87	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	3,554	3,990	3,756	3,228	2,972	2,918	2,483	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	53,686	54,302	55,335	55,117	54,818	54,983	55,138	Other resident sectors
Depozita të tjera	217,070	215,892	214,884	212,762	212,283	211,381	211,303	Other deposits
Qeveria lokale dhe administrata publike								Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	757	603	603	603	603	603	603	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	5,136	4,168	4,075	4,363	4,227	4,164	4,585	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	7,598	7,342	7,229	6,390	6,683	6,489	6,435	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	203,579	203,779	202,978	201,407	200,770	200,125	199,680	Other resident sectors
Në valutë	663,836	682,115	681,947	686,028	690,332	690,658	696,056	In foreign currency
Depozitat e transferueshme	308,556	323,036	318,823	322,884	328,421	330,078	336,876	Transferable deposits
Qeveria lokale dhe administrata publike	39	70	60	37	26	27	21	Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	2,465	3,309	4,303	4,105	5,485	3,077	2,912	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	6,143	6,699	5,948	6,290	6,585	6,382	5,818	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	116,544	124,501	119,581	123,237	124,005	127,091	131,515	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	183,366	188,457	188,932	189,214	192,320	193,501	196,610	Other resident sectors
Depozita me likuiditet të lartë (Depozita pa afat)	136,407	137,737	139,212	137,852	138,280	138,476	139,139	Liquid deposits (Sight deposits)
Qeveria lokale dhe administrata publike								Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	94	87	148	191	112	104	96	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	10	0	11	10	9	8	7	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	3,739	3,857	3,728	3,383	3,509	3,377	3,759	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	132,565	133,792	135,326	134,267	134,650	134,988	135,277	Other resident sectors
Depozita të tjera	218,873	221,342	223,912	225,292	223,631	222,103	220,041	Other deposits
Qeveria lokale dhe administrata publike	24	0	0	26	25	25.4	25.1	Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	1,519	2,341	2,349	2,493	2,157	2,139	1,473	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	8,936	8,092	8,689	7,923	8,135	6,758	7,113	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	12,622	13,941	14,063	16,105	15,246	15,267	15,354	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	195,771	196,969	198,811	198,745	198,067	197,914	196,076	Other resident sectors

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 13 **Tregues të shëndetit financiar (FSI)**
(në përqindje)

Financial Soundness Indicators (FSI)
(in percentage)

Përshkrimi i treguesit	Mar 22	Prill 22	Maj 22	Qershor 22	Index description
Tregues me bazë kapitallin					Capital-based
Kapitali rregullator ndaj aktiveve të ponderuara me rrezik (në %)	18			18.99	Regulatory capital as a percent of risk-weighted assets (in %)
Kapitali rregullator (mln lekë)	170076			181,587.16	Regulatory capital (million lek)
Aktive të ponderuara me rrezik (mln lekë)	948,127			956,054	Risk-weighted assets
Kapitali rregullator i nivelit I ndaj aktiveve të ponderuara me rrezik (në %)	17			17.78	Regulatory Tier 1 capital as a percent of risk-weighted assets (in %)
Kapitali ndaj totalit të aktiveve					Capital as a percent of total assets
Kapitali rregullator i nivelit I ndaj totalit të aktiveve	9.00	9.26	9.34	9.42	Regulatory Tier 1 capital as a percent of total assets
Kapitali rregullator ndaj totalit të aktiveve (në %)	10.00	9.93	10.00	10.06	Regulatory capital as a percent of total assets (in %)
Kapitali aksioner ndaj totalit të aktiveve (në %)	10	10.21	10.17	10.11	Shareholders' equity as a percent of total assets (in %)
Huatë me probleme neto nga proviçionet ndaj kapitalit (në %)					Nonperforming loans net of provisions as a percent of capital (in %)
Huatë me probleme neto nga proviçionet ndaj kapitalit rregullator të nivelit I (në %)	7.00	8.17	8.31	8.05	Nonperforming loans net of provisions as a percent of regulatory Tier1 capital (in %)
Huatë me probleme neto nga proviçionet ndaj kapitalit rregullator (në %)	7.00	7.62	7.76	7.54	Nonperforming loans net of provisions as a percent of regulatory capital (in %)
Huatë me probleme neto nga proviçionet ndaj kapitalit aksioner (në %)	7.00	7.41	7.63	7.49	Nonperforming loans net of provisions as a percent of shareholders' equity (in %)
Kthimi nga kapitali (ROE) (bazë vjetore) (në %)	7	8.19	7.54	7.22	Return on equity (ROE) (annual basis) (in%)
Pozicioni i hapur neto ne valutë ndaj kapitalit (në %)					Net open position in foreign exchange as a percent of capital (in %)
Pozicioni i hapur neto ne valutë ndaj kapitalit rregullator të nivelit I (në %)	11.00	11.00	9.39	8.21	Net open position in foreign exchange as a percent of regulatory Tier 1 capital (in %)
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit rregullator (në %)	10.00	10.26	8.77	7.69	Net open position in foreign exchange as a percent of regulatory capital (in %)
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit aksioner (në %)	9	9.98	8.62	7.65	Net open position in foreign exchange as a percent of shareholders' capital (in %)
Tregues me bazë aktivet					Asset-based indicators
Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve (metoda e gjerë)	28.00	30.16	29.48	28.85	Liquid assets as a percent of total assets (broad measure)
Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve (metoda bazë)	13.00	12.39	12.20	12.19	Liquid assets as a percent of total assets (core measure)
Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (deri në një vit) (metoda e gjerë)	38.00	41.61	40.71	39.90	Liquid assets as a percent of short-term liabilities (broad measure)
Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (deri në një vit) (metoda bazë)	18.00	17.10	16.85	16.85	Liquid assets as a percent of short-term liabilities (core measure)
Kthimi nga aktivet (ROA) (bazë vjetore) (fitimi neto para taksave)	1.00	0.90	0.85	0.80	Return on assets (ROA) (annual basis) (net profit before taxes)
Huatë me probleme (bruto) ndaj totalit të huave (në %)	5	5.42	5.44	5.32	Nonperforming loans (gross) as a percent of total loans (in %)
Tregues të të ardhurave dhe shpenzimeve					Income and expense-based
Marzhi i interesave ndaj të ardhurave bruto	88.00	87.79	90.53	92.99	Interest margin to gross income
Shpenzime jointeresë ndaj të ardhurave bruto	66	67.09	69.83	72.33	Noninterest expenses to gross income
Të tjera					Other
Numri i bankave	12.00	12.00	12.00	12.00	Number of banks

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania